FEDERATA E PINGPONGUT E KOSOVËS
KOSOVO TABLE TENNIS ASSOCIATION
Shtëpia e Sportit, rr. Agim Ramadani nr. 253, kati I, zyra nr. 7, Prishtinë
Tel: +383-44-170-586 / Email: info@fppk.com / ueb: www.fppk.com

Procesverbal

Nga mbledhja e 5-të e Bordit Ekzekutiv të FPPK-së e mbajtur me 14.11.2026 me fillim nga ora 18:30 në Hotel Nefron ne Prizren.

Në mbledhje ishin prezent: Nehat Çitaku, Besim Hajdari, Gani Pireva, Jahja Termkolli, Nita Baymak, Riana Rifati Canhasi dhe Sheremet Hoti.

Mungun me arsye: Ardian Lamaxhema, Shega Hashani dhe Bjondina Hasani,

Prezent ishte edhe Sekretari i Përgjithshëm, Fadil Luta, i cili u caktua të mbajë procesverbalin e takimit.

Mbledhjen e udhëhoqi Kryetari, Nehat Çitaku, i cili në fillim i përshëndeti të pranishmit duke u uruar mirëseardhje në mbledhje e pestë të BE, e pastaj e hapi mbledhjen pasi u konfirmua kuorumi, Kryetari propozoi rendin e ditës, i cili u miratua njëzëri nga Bordi Ekzekutiv:

RENDI I DITËS

1. Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Aktivitetet ndërmjet dy mbledhjeve dhe vendimet përmes Viber-i
3. Diskutim rreth situatës se krijuar nga mos pagesa e TM-ve nga MRS.
4. Te ndryshme;
    a. Aktivitetet e parapara për nëntor
        i. Liga Kosovë Shqipëri
        ii. Samiti ITTF
        iii. Turneu Dita e Flamurit
        iv. Sponzorizimet

Pika 1

Aprovimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar

Kryetari informoi të pranishmit se procesverbali i mbledhjes së kaluar është dërguar me kohë për aprovim e pastaj u është shpërndarë klubeve, por si procedurë është vendos si pikë e rendit të ditës për aprovim formal, Pas diskutimeve të zhvilluara nga të pranishmit, unanimisht u mor ky:

VENDIM

I. Aprovohet procesverbali nga mbledhja e kaluar

Pika 2.

Vendimet përmes viberit dhe Aktivitetet ndërmjet dy mbledhjeve

Kryetari informoi anëtarët e Bordit mbi aktivitetet e shumta të realizuara ndërmjet dy mbledhjeve, ku veçoi:

Pjesëmarrjen në turneun "Stiga Masters", në të cilin Zana Bllaca zuri vendin e 11-të, duke shënuar një sukses të rëndësishëm për pingpongun kosovar. Pastaj, organizimin e garave për Kupën e Kosovës, turneun TOP 8 për kategoritë U11 dhe U17, pjesëmarrjen në Kampionatin Evropian të Seniorëve, bashkorganizimin e turneut "Gani Maloku", pjesëmarrjen në Kampionatin Ballkanik të Veteranëve, si dhe aktivitetin e fundit që është duke u zhvilluar aktualisht në Turqi, Kampionatin Evropian për U13, ku sportistët tanë kanë zënë vendin e 27-të nga 30 shtete pjesëmarrëse, dhe për të cilin së shpejti do të pranohet raporti i trajnerëve dhe i drejtorit të përfaqësueses.

Vendimet e miratuara përmes platformës Viber:

Gjatë kësaj periudhe ndër mbledhëse, anëtarët e bordit kanë votuar dhe kanë miratuar në grupin e Viber-it këto vendime:

1. **08 tetor 2026:** Vendimi për aprovimin e listës për pjesëmarrje në ETTU U13 në Turqi, në përbërje: Sportistë, Imran Duraki, Denat Makolli, Arijon Krasniqi, Zana Bllaca, Adena Berisha dhe Erina Vranovci, Trajnerë, Naser Hasani dhe Remzi Shala, shoqërues Milot Makolli.
2. **09 tetor 2026:** vendimi për caktimin e datave për organizimin e WTT Feeder Prishtina 2027, 5-9 Maj 2027 dhe WTT Youth Contender Prishtina 2027, 11 deri 14 maj 2027
3. **21 tetor 2026:** Vendimi për caktimin e SHFMU Hysen Rexhepi si vendin e organizimit të ligës Kosovë Shqipëri
4. **21 tetor 2026:** Vendimi për përzgjedhjen e shkollave Hysen Rexhepi dhe Fatmir Berisha qendra për organizimin e garave të FPPK-së
5. **10 nëntor 2026:** Vendimi për paraqitjen preliminare në kualifikimet për kampionatin Evropian ekipor të seniorëve dhe senioreve.

Pika 3

Diskutim rreth situatës se krijuar nga mos pagesa e TM-ve nga MRS.

Kryetari e hapi këtë pikë duke shprehur shqetësimin për vonesat në pranimin e kësteve tremujore (TM) nga MSR-ja për vitin 2026. Ai theksoi se deri më tani është pranuar vetëm TM1, edhe pse federata i ka kryer në kohën e duhur të gjitha procedurat e nevojshme të parapara nga ministria për pranimin e këtyre mjeteve. Po ashtu, federata i ka realizuar të gjitha aktivitetet e parapara në kalendar, për dallim nga disa federata të tjera që i kanë pezulluar aktivitetet e tyre në mungesë të mjeteve.

Ai tutje informoi të pranishmit për takimet e mbajtura me zyrtarë të MSR-së, si dhe për emailet që i janë dërguar Ministrisë dhe Komitetit Olimpik të Kosovës (KOK) për të mënjanuar këtë situatë. Gjithashtu, i njoftoi anëtarët edhe për federatat e tjera që i janë drejtuar me shkrim ministrisë, përfshirë edhe emailin që Federata e Çiklizmit ia ka dërguar KOK-ut.

Duke pasur parasysh se asnjëri nga hapat e mëparshëm nuk ka dhënë rezultat, Kryetari propozoi që të ndërmerret një hap i ri: thirrja e federatave në një takim të përbashkët, ku do të ftohen edhe përfaqësues të MSR-së dhe KOK-ut, sipas tekstit të përgatitur paraprakisht (dhe të shpërndarë në grupin e Viber-it).

Të gjithë të pranishmit diskutuan për situatën, për vështirësitë që po kalon federata, si dhe për propozimin e Kryetarit për t'u dërguar ftesë federatave të tjera me qëllim të diskutimit të kësaj gjendjeje. U propozua që ftesa të dërgohet për javën pasuese. Po ashtu, u shqyrtua edhe memorandumi me MSR-në lidhur me mundësinë e angazhimit të përmbaruesit.

Ata po ashtu diskutuan edhe për obligimet dhe borxhet që ka federata, në të cilat përfshihen: mëditjet e ndryshme për gjyqtarë, anëtarë të komisioneve e të bordit, organizatorë të garave dhe trajnerë; pastaj shpërblimet për arritjet e klubeve dhe sportistëve në garat vendore, si dhe detyrimet ndaj furnitorëve dhe fituesve të turneut "Prishtina Open", të cilët po kërkojnë me ngulm alokimin e mjeteve.

Pas diskutimeve, Bordi njëzëri mori këtë:

VENDIM

I. APROVOHET dërgimi i ftesës për takim tek federatat sportive si në propozimin e kryetarit.

Pika 4.

Te ndryshme

a. Aktivitetet e parapara për nëntor

i. Liga Kosovë Shqipëri

Kryetari informoi të pranishmit se përgatitjet për organizimin e ligës mbarëkombëtare Kosovë Shqipëri, e cila është paraparë të mbahet më 21 dhe 22 nëntor në Prizren, po shkojnë sipas planit. Ai bëri të ditur se deri më 16 nëntor do të konfirmohen emrat e pjesëmarrësve, e më pas do të vazhdohet me rezervimet për akomodim në hotele, si dhe me dërgimin e ftesave të personalizuara.

ii. Samiti ITTF

Kryetari informoi të pranishmit për ftesën që ka marrë për Samitin e ITTF-së, i cili do të mbahet në Turqi nga 23 deri më 25 nëntor, ku shpenzimet e akomodimit mbulohen nga organizatori. Në këtë samit, ndër të tjera, do të diskutohet edhe për projektin e fituar "Programi në Shkolla".

iii. Turneu Dita e Flamurit

Kryetari informoi të pranishmit edhe për zgjedhjet e Komisionit të Sportistëve, të cilat janë paraparë të mbahen në ditën e organizimit të turneut të seniorëve "Dita e Flamurit", 29 nëntor, ku deri më tani është paraqitur vetëm një kandidat. U potencua se pritet që kandidatët e tjerë të paraqiten deri më 20 nëntor; në rast të mosplotësimit të kriterit (paraqitjes së të paktën 3 kandidatëve), federata obligohet t'i shtyjë zgjedhjet për një afat tjetër

iv. Sponsorizimet

Kryetari informoi të pranishmit se me 3 sponsorët janë nënshkruar marrëveshjet e sponsorizimit dhe të njëjtat janë dërguar në ministri për marrjen e vërtetimeve. Deri më tani është pranuar vërtetimi për "Metal Kosova", ndërsa federata është në pritje të vërtetimeve edhe për "Tick Media" dhe "Marigona Sun" (Hotel Marriott). Këto sponsorizime, siç ka qenë e paraparë, janë të orientuara për blerjen e pajisjeve; posa të pranohen mjetet në llogari, do të mbahet një mbledhje e Bordit për të vendosur se me cilin furnitor do të vazhdohet

Mbledhja përfundoj në ora 20:15

Procesmbajtës **Kryesuesi i mbledhjes**

Fadil Luta **Nehat Çitaku**